



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**  
**DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Nr. \_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . 2023

Lënda: Mbi dokumentin e programit buxhetor afatmesëm të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për periudhën 2024-2026, faza teknike

**KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE**  
**DHE TË DREJTAT E NJERIUT**

**Tiranë**

Të nderuar anëtarë,

Në zbatim të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 7, datë 28.02.2018, “Për Procedurat Standarde të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, udhëzimit nr. 5, datë 28.02.2023, “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”, si dhe udhëzimit plotësues nr. 22, datë 07.07.2023, “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”, po ju parashtrojmë dokumentin e programit buxhetor afatmesëm të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për periudhën 2024-2026, faza teknike, miratuar me vendimin nr. 06, datë 31.08.2023, të Mbledhjes së Gjyqtarëve dhe Grupit për Menaxhimin Strategjik të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, sipas këtij materiali dhe dokumenteve bashkëlidhur.

Kolegji i Posaçëm i Apelit (këtu e në vijim “Kolegji”) është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 179/b dhe Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si një ndër tri institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Referuar nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, Kolegji funksionon pranë Gjykatës Kushtetuese, si kolegji i dytë i saj. Gjyqtarët e Kolegjit, referuar pikës 3 të nenit C të Aneksit të Kushtetutës, gjatë mandatit të tyre gëzojnë statusin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

Në përmbushje të detyrave të ngarkuara nga Kushtetuta dhe ligji, Kolegji mbështetet nga Njësia e Shërbimit Ligjor dhe punonjësit administrativë. Kuvendi i Shqipërisë, me vendimin nr. 92/2017, i ndryshuar me vendimin nr. 35/2022, ka miratuar strukturën organizative, organikën dhe klasifikimin e pagave të personelit të Kolegjit të Apelit, sipas të cilit numri total i punonjësve është 57 (pesëdhjetë e shtatë).

Për procesin e hartimit të kërkesave buxhetore afatmesme të Kolegjit të Apelit për fazën teknike janë ndjekur këta hapa:

1. përcaktimi i misionit të institucionit dhe përshkrimi i programit buxhetor;
2. përcaktimi i qëllimit të politikës dhe objektivave të programit;
3. përcaktimi i treguesve të performancës për çdo objektiv të programit;
4. formulimi i produkteve mbi bazën e rezultateve të përcaktuara;
5. ndarja e kërkesave buxhetore sipas politikave ekzistuese dhe politikave të reja.

**Misioni i KPA-së është:** “Përmbushja e funksioneve dhe kompetencave ligjore për garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi”.

Kolegji i Apelit funksionon me një program të vetëm buxhetor me emërtesën: “Veprimtaria e Apelit të Rivlerësimit Kalimtar”.

**Përshkrimi i Programit:** “Mbështetja e veprimtarisë së Kolegjit të Posaçëm të Apelit për shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit; ushtrimin e juridiksionit disiplinor ndaj subjekteve të përcaktuara në ligj si dhe shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të organeve të sistemit të drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore”.

**Qëllimi i Politikës së Programit:** “Funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimi i besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi”.

Si tregues i performancës, i projektuar për të matur impaktin e këtij qëllimi, është përcaktuar: “Pavarësia dhe funksionimi i sistemit ligjor”.

Përcaktimi i vlerës bazë, si dhe vlerës për tri vitet e ardhshme, për efekt të procesit të parashikimit të kërkesave buxhetore afatmesme, është kryer duke përdorur si burim informacioni studimet vjetore të publikuara nga “Freedom House”, organizatë e pavarur, financuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit, e specializuar në studime mbi demokracinë, respektimin e lirive dhe të drejtave, si dhe funksionimin e shtetit (<https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2023>).

Sa i përket vlerësimit të sistemit gjyqësor, ky studim paraqet rezultatet në formën e një indeksi me vlera nga 0 - 4, ku nr. 0 paraqet vlerësimin minimal dhe nr. 4 atë maksimal. Në raportin e vitit 2023, ku paraqitet vlerësimi për vitin 2022, sistemi gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, paraqitet në nivelin 2.

Ne gjykojmë se si rrjedhojë e thellimit të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe krijimit e konsolidimit të organeve të reja të drejtësisë në vitet në vijim, ky indeks do të vijë drejt një përmirësimi gradual nga niveli 2.5 në vitin 2024, në nivelin 3 deri në vitin 2026.

Për realizimin e programit buxhetor, është përcaktuar si objektivi kryesor:

**Objektivi 1 -** “Të shqyrtojë çështjet e ankimuarra nën juridiksion, bazuar në një proces të rregullt ligjor”.

Treguesi i performancës i projektuar për të matur rezultatin e lidhur me këtë objektivi, është: “Numri i çështjeve të përfunduara në raport me numrin e çështjeve të ankimuarra”. Vlera e projektuar për këtë tregues performance për periudhën 2024-2026, është vlerësuar në masën 57-100%.

Deri në datën 31 korrik 2023, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit janë regjistruar për shqyrtim 340 çështje të juridiksionit të rivlerësimit (40 çështje gjatë vitit 2018, 62 çështje gjatë vitit 2019, 63 çështje gjatë vitit 2020, 86 çështje gjatë vitit 2021, 53 çështje gjatë vitit 2022, si dhe 36 çështje gjatë vitit 2023).

Deri më datën 31 korrik 2023, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit janë shpallur 211 vendime të juridiksionit të rivlerësimit ose rreth 62% e çështjeve të regjistruara.

Si produkt kryesor për realizimin e objektivit 1, është përcaktuar “Çështje të ankimuarra /shqyrtuara”, duke parashikuar dhe numrin e çështjeve për periudhën 2024-2026.

Nga të dhënat statistikore të deritanishme, rezulton se nga rreth 805 subjekte rivlerësimi në total, është ndërprerë procesi i rivlerësimit për 28 subjekte (ndërprerja e vetingut për shkak të moshës dhe dorëheqjeve). Nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, deri më 31 korrik 2023 janë dhënë 686 vendime. Bazuar në përcaktimet ligjore, të gjitha çështjet e shqyrtuara nga KPK-ja janë potencialisht të mundshme për ankimim pranë Kolegjit të Apelit, megjithatë, nga të dhënat e deritanishme, rezulton se rreth 50% e vendimeve të dhëna nga KPK-ja janë apeluar pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Sa i takon të drejtës së ushtrimit të juridiksionit disiplinor ndaj subjekteve të përcaktuara në ligj, si dhe shqyrtimit të ankimeve kundër vendimeve të organeve të sistemit të drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, aktualisht Kolegji i Apelit, deri më 31 korrik 2023, ka

shqyrtuar 18 çështje në total, si dhe janë shpallur 7 vendime përfundimtare dhe 8 vendime për moskalim të çështjes në seancë.

Bazuar në sa më sipër, për efekt planifikimi buxhetor, për vitin 2024, kemi parashikuar si potencialisht të ankimueshme për t'u gjykuar nga Kolegji i Apelimit, 70 çështje (60 çështje të juridiksionit të rivlerësimit dhe 10 çështje të juridiksionit disiplinor). Për vitin buxhetor 2025, numri i çështjeve potencialisht të ankimueshme parashikohet i njëjtë, ndërsa për vitin 2026, që është dhe viti i përfundimit të mandatit të Kolegjit, numri i parashikuar i çështjeve është 35 (30 çështje të juridiksionit të rivlerësimit dhe 5 çështje të juridiksionit disiplinor).

Kërkesa buxhetore për vitin 2024 është e orientuar në tre zëra shpenzimesh:

1. shpenzime personeli (paga dhe sigurime shoqërore);
2. shpenzime operative;
3. investime;

Buxheti total i parashikuar për mbështetjen e veprimtarisë së Kolegjit të Apelimit për vitin 2024, është **336.5 milionë lekë**. Tavani buxhetor i përcaktuar për vitin 2024, është **207.4 milionë lekë**.

Në udhëzimin plotësues nr. 22, datë 07.07.2023, "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026", përcaktohet se: "*Objektivi i fazës teknike të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026, është përpunimi i detajeve teknike të buxhetit brenda tavanëve përfundimtare të miratuara. Në këtë kuptim, Njësitë e Qeverisjes Qendrore nuk mund të risjellin kërkesa për financimin e politikave të reja dhe kërkesa për mangësitë në financim të politikave ekzistuese*".

**Pavarësisht përcaktimit të mësipërm, në zbatim të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni C, pika 14 e tij, si dhe nenit 19, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", kërkesat buxhetore për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit janë hartuar bazuar në nevojat konkrete dhe nuk marrin në konsideratë tavanet indikative të miratuara për KPA-në, me VKM nr. 436, datë 19.07.2023, "Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve për PBA 2024-2026".**

Në materialin në vijim, paraqitet në mënyrë të detajuar dhe argumentuar kërkesa për çdo artikull ekonomik, për vitin 2024.

## 1. Shpenzimet e personelit

Kërkesat buxhetore në shpenzime personeli, për vitin 2024, janë përllogaritur në vlerën totale **296.7 milionë lekë** dhe përfshijnë:

- a) Vlerën **235.8 milionë lekë** paga dhe sigurime shoqërore për 57 (pesëdhjetë e shtatë) punonjës të miratuar me vendimin nr. 92/2017 të Kuvendit të Shqipërisë, ndryshuar me vendimin nr. 35/2022, si dhe 1 (një) punonjës me kontratë të përkohshme të parashikuar për vitin 2024, në rast miratimi të ndryshimeve në strukturën organike të Kolegjit, të parashikuara më poshtë, në pikën "c" të këtij paragrafi. Ky fond konsiston përkatësisht në: 216.3 milionë lekë për paga dhe 19.5 milionë lekë për sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Në përllogaritjen këtij fondi jemi mbështetur në:
  - Pikat 3, 4 dhe 5, neni 29, ligji 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; nenin 17, ligji nr. 8577, datë 10.02.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenin 12, ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; VKM nr. 574, datë 9.10.2017, "Për përcaktimin e pagës mujore shtesë për shkak të vështirësisë, për anëtarët e institucioneve të rivlerësimit"; vendimin nr. 92/2017 të Kuvendit të Shqipërisë, i ndryshuar me vendimin

nr. 35/2022, si dhe vendimin nr. 35, datë 22.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese, **sa u takon gjyqtarëve të Kolegjit të Apelit, këshilltarëve të Njesisë së Shërbimit Ligjor.**

- Vendimin nr. 92/2017 të Kuvendit të Shqipërisë, i ndryshuar me vendimin nr. 35/2022, VKM-në nr. 325, datë 31.05.2023, VKM-në nr. 326, datë 31.05.2023, **sa u takon punonjësve administrative.**
- Aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për pagesën e kontributit të sigurimit shoqëror dhe kontributit të sigurimit shëndetësor që punëdhënësi kryen për punëmarrësit.

b) Vlerën **51.1 milionë lekë** paga dhe sigurime shoqërore ku janë përlllogaritur fondet e kërkuara lidhur me efektin prapaveprues për periudhën prill 2019 - dhjetor 2022, në llogaritjen e pagave dhe sigurimeve shoqërore për gjyqtarët dhe këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor, në zbatim të vendimit nr. 35, datë 22.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e pikës 5 të nenit 12 të ligjit 96/2016. Ky fond konsiston përkatësisht në: 50.2 milionë lekë për paga dhe 855 mijë lekë për sigurime shëndetësore.

Bazuar në përcaktimet e udhëzimit të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 7, datë 28.02.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, kërkesa për shpenzime personeli (pika a dhe b) për vitin 2024, për numrin organik aktual (57 + 1) të punonjësve, është konsideruar si pjesë e **politikës ekzistuese** të Kolegjit të Apelit.

c) Vlerën **9.8 milionë lekë** paga dhe sigurime shoqërore ku janë përlllogaritur ndryshimet e kërkuara në strukturën organike, sipas shkresës nr. 803 prot., datë 05.07.2023, drejtuar Kuvendit të Shqipërisë lidhur me:

- riklasifikimin e pagës për funksionin organik “Drejtor” nga klasa II-1, në klasën I-5;
- riklasifikimin e pagës për funksionin organik “Kordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë” nga klasa III-1, në klasën II-1;
- ndryshimin e emërimit të pozicionit “Sekretar i Kryetarit”, në emërtimin “Këshilltar pranë Mbledhjes së Gjyqtarëve dhe Kryetarit”, i shoqëruar me ndryshim të kategorisë së pagës nga 90.000 lekë, në klasën në II-1;
- shtesë në strukturën organike për 6 (gjashtë) punonjës për funksione ekzistuese, që aktualisht mbulohen nga punonjës me kontratë të përkohshme pune.

Sa i takon shtesës në strukturën organike me 6 (gjashtë) punonjës, shpjegojmë se këto pozicione janë të miratuara për Kolegjin e Posaçëm të Apelit, sipas VKM-së nr. 56, datë 01.02.2023, me kontratë të përkohshme pune dhe për të cilët kërkohet përfshirja në strukturën organike me kohë të plotë.

Efekti financiar i këtij ndryshimi, përkatësisht 8.6 milionë lekë paga dhe 1.2 milionë lekë sigurime shoqërore, është konsideruar si **politike e re**, pasi për këtë propozim nevojitet miratim ligjor.

Për dy vitet e tjera të PBA-së 2025 dhe 2026, kërkesat buxhetore për shpenzime personeli janë parashikuar përkatësisht **245.6 milionë lekë** dhe **122.8 milionë lekë**.

Në ndryshim nga parashikimi i kryer në fazën e parë (strategjike), fondi i nevojshëm për shpenzime personeli është rillogaritur duke pasur parasysh ndryshimet e miratuara me VKM nr. 325, datë 31.05.2023 dhe VKM nr. 326, datë 31.05.2023, sa u takon punonjësve administrativë, si dhe pagesën e kryer për efektin prapaveprues të pagave, më zbatim të vendimit nr. 35, datë 22.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese për periudhën qershor 2017 - mars 2019.

## 2. Shpenzime operative

Buxheti për shpenzime operative përfshin tërësinë e mallrave dhe shërbimeve të domosdoshme gjatë aktivitetit vjetor, në mbështetje të ushtrimit të funksioneve që Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 i ngarkon Kolegjit të Apelimit.

Në përllogaritjen e fondeve buxhetore për shpenzime operative, jemi mbështetur kryesisht në:

- treguesit e realizuar të shpenzimeve operative për vitin 2020 - 2022 dhe shpenzimeve të parashikuara për vitin 2023, si dhe kërkesat specifike të paraqitura nga dy drejtoritë.

Buxheti total i parashikuar në shpenzime operative për vitin 2024, për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, është **25.1 milionë lekë**.

Në vijim, janë paraqitur kërkesat për vitin 2024, sipas grupeve kryesore të shpenzimeve operative.

### 602.0 - Materiale dhe shërbime zyre të përgjithshme

Kjo kategori shpenzimesh, e përllogaritur në vlerën **2.3 milionë lekë**, përfshin zërat e mëposhtëm.

*në 000 lekë*

Kancelari, letër	900
Materiale për pastrim e higjieno-sanitare	600
Materiale elektrike, ndriçim etj.	100
Materiale për funks. e zyrave (tonera)	500
Materiale për funks. pajisjeve speciale	100
Materiale të tjera zyre dhe të përgjithshme	100

Në zërin “Materiale për funksionimin e zyrave (tonera)”, janë parashikuar nevojat vjetore për vitin 2024, që do të përfshihen në procedurën e prokurimit të llojit marrëveshje kuadër për 3 vitet e ardhshme. Në planifikimin e kryer në fazën e parë (strategjike), ky zë ishte planifikuar në vlerën 1 milion lekë, por pas studimit të tregut për efekt të zhvillimit të procedurës së prokurimit, kjo vlerë është ulur në 500 mijë lekë. Gjithashtu është parashikuar dhe një rritje në vlerën e planifikuar për kancelari dhe letër, në vlerën 200 mijë lekë, si pasojë e rritjes së konsumit për shkak të rritjes së numrit të punonjësve.

### 602.1 - Materiale dhe shërbime speciale

Kjo kategori shpenzimesh, e përllogaritur në vlerën **640 mijë lekë**, përfshin zërat e mëposhtëm.

*në 000 lekë*

Furnizime me ujë të pijshëm për seancat dhe personelin	250
Ilaçe dhe materiale mjekësore	10
Abonim në shtypin e shkruar	100
Shpenz. për prodhim dokumentacioni specifik	120
Dezinfektim i ambienteve	60
Të tjera mater. dhe shërbime speciale	100

- Në zërin “Ujë i pijshëm”, është parashikuar mbulimi i nevojave për personelin e Kolegjit, si dhe palët pjesëmarrëse gjatë proceseve gjyqësore.
- Në zërin “Dezinfektim i ambienteve”, është planifikuar dezinfektimi kundër insekteve që mbartin patogjenë të dëmshëm për shëndetin, sipas nevojës.

### 602.2 - Shërbime nga të tretët

Kjo kategori shpenzimesh, e përllogaritur në vlerën **3.7 milionë lekë**, përfshin zërat e mëposhtëm.



në 000 lekë

Elektricitet	1.700
Ujë	150
Shërbime telefonike	1000
Posta dhe shërbim korrieri	110
Shërbime bankare	5
Kosto të trajnimit dhe seminareve	150
Shërbime të printimit dhe publikimit	500
Shërbim interneti për ambiente me qira	50
Shërbime të tjera	100

- Në zërat “Elektricitet” dhe “Ujë”, përveç konsumit në godinën aktuale, është parashikuar dhe konsumi për ambiente shtesë të marra me qira, në dispozicion të Kolegjit.
- Në zërin “Kosto të trajnimit dhe seminareve”, janë parashikuar trajnime për stafin administrativ, të organizuara nga shkolla e administratës publike, sipas tarifave të parashikuara në VKM-në nr. 687, datë 18.11.2021.
- Në zërin “Shërbime telefonike”, në zbatim të VKM-së nr. 855, datë 02.11.2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 673, datë 02.09.2020, “Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë”, si dhe Vendimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 28, datë 21.12.2020, i cili ka miratuar kuotat maksimale për telefoninë celulare sipas funksioneve, është llogaritur vlera e kontratës institucionale për titullarin e institucionit, këshilltarët ligjorë dhe ekonomikë, Sekretarin e Përgjithshëm dhe drejtorët e drejtorive.
- Zëri “Shërbime printimi dhe publikimi” ka të bëjë me publikimet në median e shkruar dhe atë online të pozicioneve vakante të punësimit për shtesat në strukturë, si dhe pozicionet vakante që mund të krijohen gjatë vitit në institucion.

### 602.3 - Shpenzime transporti

Kjo kategori shpenzimesh, e përlllogaritur në vlerën **560 mijë lekë**, përfshin zërat e mëposhtëm.

në 000 lekë

Karburant për automjetin dhe gjeneratorin	250
Pjesë këmbimi, goma dhe bateri	50
Shpenzime siguracioni të mjeteve	60
Shpenzime të tjera transp. (parkim për automjetin )	200

- Në zërin “Karburant”, gjatë vitit 2024, është parashikuar një sasi prej 1200 litër (100 litër / muaj) për automjetin e institucionit.
- Në zërin “Pjesë këmbimi, goma dhe bateri” me vlerë 50 mijë lekë, është vlerësuar prokurimi i pjesëve që mund të dëmtohen për automjetin e institucionit, të cilat nuk klasifikohen si shërbime, sipas vlerësimit të kryer nga shoferi i automjetit.
- Në zërin “Shpenzime të tjera transporti” është përfshirë rinovimi i kontratës më Bashkinë Tiranë për vend parkimin e automjetit të institucionit.

### 602.4 - Shpenzime udhëtimi

Kjo kategori shpenzimesh, e përlllogaritur në vlerën **3.9 milionë lekë**, përfshin zërat e mëposhtëm.

në 000 lekë

Udhëtim i brendshëm	500
Udhëtim jashtë shtetit	3.400

- Lidhur me “Udhëtimet e brendshme”, është parashikuar një fond, duke u bazuar në nenin 49, pika Ç e ligjit 84/2016, ku parashikohet se me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, Kolegji ka të drejtë të këqyrë dhe kontrollojë sende të luajtshme apo të paluajtshme, bazuar në vendimin e gjykatës kompetente, si dhe zhvillimin e dy seminareve brenda Shqipërisë, në kuadër të juridiksionit disiplinor.

- Në zërin “Udhëtime jashtë vendit”, nisur nga fakti që anëtarët e Kolegjit mund të marrin pjesë në konferenca të ndryshme ndërkombëtare, takime apo trajnime me organe të juridiksionit disiplinor, për proces të rregullt gjykimi e shkëmbim eksperience, është parashikuar mbulimi i shpenzimeve për 1 (një) udhëtim 3-ditor për shtatë gjyqtarë për vizita studimore në gjykata homologe; 1 (një) udhëtim 4-ditor për 14 (katërbëdhjetë) këshilltarë të Njësisë së Shërbimit Ligjor për trajnim në kuadër të Juridiksionit Disiplinor në GjEDNj apo gjykata evropiane, të cilat kanë në juridiksionin e tyre procedime disiplinore. Gjithashtu, në këtë zë është përfshirë dhe një udhëtim 3-ditor për personelin (3 persona/udhëtim) për takimet vjetore të Komitetit të Stabilizim Asociimit, në Bruksel. Baza ligjore për shpenzimet e parashikuara më sipër është VKM-ja nr. 870, datë 14.11.2011, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.

### 602.5- Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme

Kjo kategori shpenzimesh, e përlogaritur në vlerën **1.9 milion lekë**, përfshin zërat e mëposhtëm.

*në 000 lekë*

Shpenzime për mirëmbajtjen sistemeve dhe instalimeve	1720
Shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit	120
Shpenzime për mirëmbajtjen dhe riparim pajisje zyre	85

Në zërin “Mirëmbajtje e sistemeve dhe instalimeve teknike”, janë përfshirë:

a. Mirëmbajtja e serverëve, kompjuterëve dhe pajisjeve të zyrës të institucionit, në vlerën 1.720 mijë lekë, si vijim i praktikës së prokurimit të kryer për vitin 2023.

b. Mirëmbajtja vjetore e sistemit audio-video të instaluar në sallën e gjyqit, me vlerë 85 mijë lekë, bazuar në kontratën aktuale që përfundon në muajin shtator 2023.

### 602.6- Shpenzime për qiramarrje ambientesh

Buxheti i detajuar për këtë kategori shpenzimi, është përlogaritur në vlerën **1.7 milion lekë** dhe përfshin pagesën vjetore të qirasë për ambientet shtesë, në përdorim të Kolegjit. Bazuar në nenin 3 të kontratës aktuale, brenda muajit gusht 2023, Kolegji do të kërkojë me shkrim nga pala qiradhënëse rinovimin e kontratës dhe për një periudhë 1- (një) vjeçare.

### 602.9 - Shpenzime të tjera materiale dhe shërbime operative

Kjo kategori shpenzimesh, e përlogaritur në vlerën **10.3 milionë lekë**, përfshin zërat e mëposhtëm.

*në 000 lekë*

Shpenzime për sigurimin e jetës, shëndetit dhe pasurisë	8.700
Shpenzime telefonie gjyqtarë	1080
Shpenz. kompensimi për pasaportë diplomatike	60
Shpenzime për tatim & taksa për institucionin	100
MKZ	20
Blerje materiale hidraulike, marangozi, ndërtimi etj.	100
Dekorim i festave të fundvitit	10

Blerje licencash Microsoft Office 365 dhe Zoom meeting	120
Mirëmbajtje faqe zyrtare	120

- Në zërin “Sigurimi i jetës, shëndetit dhe pasurisë”, bazuar në pikën 17 të nenit “C” të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 25 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, rinovimin e paketës ekzistuese për gjyqtarët dhe personat e lidhur, si dhe për këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor dhe stafin administrativ. Në planifikimin e kryer në fazën e parë (strategjike), ky zë ishte planifikuar në vlerën 7 milionë lekë, por pas studimit të tregut, për zhvillimin e procedurës së prokurimit të vitit 2023, rezultoi se çmimet e ofertuara kanë pësuar një rritje, si pasojë e ecures së kontratave të mëparshme. Për rrjedhojë, bazuar në këtë studim dhe vendimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 52, datë 30.05.2023, vlera e planifikuar për këtë qëllim është 8.7 milionë lekë.

- Në zërin “Shpenzime telefonie për gjyqtarët”, është parashikuar fondi për mbulimin e shpenzimeve telefonike, bazuar në VKM-në nr. 855, datë 02.11.2020, dhe Vendimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 28, datë 21.12.2020.

- Në zërin “Blerje licencash”, përveç rinovimit të shërbimit Microsoft Office 365, është përfshirë dhe rinovimi i shërbimit Zoom Meeting për punën në distancë.

Kërkesa për shpenzime operative për vitin 2024, në vlerën 25.1 milionë lekë, është konsideruar si pjesë e politikës ekzistuese të Kolegjit të Apelit.

Për vitin 2025, kërkesa buxhetore për shpenzime korrente është përcaktuar **272.7 milionë** lekë, pasi nuk është parashikuar rritje për nivelin e inflacionit sipas përcaktimeve në udhëzimin për hartimin e kërkesave buxhetore afatmesme dhe janë zbritur shpenzime që nuk konsiderohen të domosdoshme gjatë kësaj periudhe.

Për vitin 2026, kërkesa buxhetore për shpenzime korrente është përcaktuar **132 milionë** lekë, duke pasur parasysh përfundimin e mandatit të Kolegjit sipas parashikimit ligjor.

### 3. Shpenzimet për investime

Për vitin 2024, Kolegji i Posaçëm i Apelit ka parashikuar në investime fondin **13.3 milion lekë**. Tavani buxhetor i përcaktuar për vitin 2024 është **2 milionë lekë**. Përdorimi i këtij fondi për vitin 2024, parashikohet si më poshtë.

1. Prokurim për 3 (tre) kompjuterë rezervë dhe pajisje elektronike, për rastet e dëmtimeve gjatë vitit të cilat nuk mund të riparohen, duke pasur parasysh faktin që në vitin 2024, shumica e pajisjeve elektronike/kompjuterike do të jenë në vitin e gjashtë të përdorimit, duke rritur mundësinë e daljes nga përdorimi për shkak të defekteve dhe konsumit, si dhe dhe cenuar aktivitetin e punës.

Parashikimi për këtë grup investimesh është llogaritur në vlerën **1.200 mijë lekë**.

2. Prokurim për 5 (pesë) karrige rezervë për specialistë dhe pajisje zyre e mobilie, për rastet e dëmtimeve gjatë vitit të cilat nuk mund të riparohen.

Parashikimi për këtë grup investimesh është llogaritur në vlerën **800 mijë lekë**.

Bazuar në përcaktimet e udhëzimit për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm, kjo kërkesë është trajtuar në kategorinë shpenzime administrative kapitale dhe përfshihet në politikat ekzistuese për projektet e investimeve publike.

3. Scanner për kontroll dhe urë metal dedektor, në vlerë **12,7 milion lekë**. Kjo është një kërkesë e përsëritur e Kolegjit prej vitit 2019, e cila nuk është miratuar. Theksojmë se ky investim garanton sigurinë e personelit të Kolegjit, si dhe të palëve pjesëmarrëse në proces. Bazuar në përcaktimet e udhëzimit për hartimin e Programit Buxhetor



Afatmesëm, kjo kërkesë është trajtuar në kategorinë shpenzime për projekte investimesh dhe përfshihet në politikat e reja për projektet e investimeve publike.

Për gjithë sa parashtruar më sipër, si dhe bazuar në nenin C/16 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kërkojmë mirëkuptimin dhe mbështetjen tuaj për akordimin e plotë të buxhetit të kërkuar për vitin 2024, me qëllim realizimin e politikave të parashtruara nga Kolegji i Posaçëm i Apelit në këtë fazë teknike të hartimit të kërkesave buxhetore, në përmbushje të funksioneve që ligji 84/2016 dhe Kushtetuta e Shqipërisë i ngarkon këtij institucioni kushtetues.

Bashkëlidhur gjeni tabelat plotësuese, si dhe formatet standarde për hartimin e kërkesave buxhetore afatmesme 2024-2026.

Duke ju falënderuar për vëmendjen,